



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
	KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PRESEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 7734 Nr. i faq/Br.str/No.pg 76		
Data/Datum/Date 5 / 8 / 26		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Procesverbal nga takimi me qytetarët e Rahovecit, me fokus SHPG “HAREJA” BUXHETIMI GJINOR

I. TË DHËNAT E PËRGJITHSHME

Në kuadër të procesit të përgatitjes së Buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027, më datë 24.07.2026 u mbajt dëgjim buxhetor me përfaqësueset e SHPG “Hareja”, ne krye me **znj. Adelina Paqarizi**, me qëllim të identifikimit të nevojave, sfidave dhe prioritetëve të grave dhe komunitetit, si dhe të diskutimit mbi mundësitë për përfshirjen e tyre në planifikimin buxhetor komunal.

Takimi u zhvillua në frymën e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2027, me theks të veçantë në buxhetimin gjinor dhe në krijimin e mundësive të barabarta për të gjitha kategoritë e shoqërisë.

II. ZHVILLIMI I TAKIMIT

Afrim Limani: Përshëndeti të pranishmit dhe falënderoi përfaqësuesen e SHPG “Hareja”, znj. Adelina Paqarizi, për pjesëmarrjen në dëgjimin buxhetor. Në cilësinë e Drejtorit për Buxhet dhe Financa, theksoi rëndësinë e këtyre takimeve në procesin e përgatitjes së buxhetit komunal për vitin 2027.

Ai theksoi se dëgjimet buxhetore janë një mundësi e mirë që qytetarët, organizatat dhe grupet e ndryshme të komunitetit t'i paraqesin drejtpërdrejt nevojat dhe prioritetet e tyre. Sipas tij, Komuna është e interesuar që gjatë hartimit të buxhetit të merren parasysh nevojat reale të komunitetit dhe të krijohet një planifikim sa më gjithëpërfshirës.

Drejtori Limani theksoi gjithashtu rëndësinë e buxhetimit gjinor dhe të përfshirjes së perspektivës gjinore në planifikimin e politikave dhe shpenzimeve publike. Ai bëri të ditur se kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimit do të evidentohen dhe do të shqyrtohen nga drejtoritë përkatëse, në përputhje me kompetencat dhe mundësitë buxhetore të Komunës.

Adelina Paqarizi: Falënderoi Komunën për organizimin e dëgjimit buxhetor dhe theksoi se takime të tilla janë të rëndësishme për të përcjellë nevojat dhe shqetësimet e grave dhe kategorive të tjera të komunitetit.

Ajo theksoi se gjatë planifikimit të buxhetit duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë grave të moshuara, familjeve në nevojë, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve dhe kategorive të tjera që kanë nevojë për mbështetje institucionale.

Në këtë drejtim, kërkoi që në buxhetin për vitin 2027 të planifikohen masa dhe programe konkrete që do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e mirëqenies sociale dhe ekonomike të qytetarëve.

Afrim Limani: Theksoi se Komuna e vlerëson kontributin e organizatave të shoqërisë civile dhe se kërkesat e tyre janë të rëndësishme për identifikimin e nevojave që duhet të merren parasysh gjatë planifikimit buxhetor.

Ai sqaroi se jo të gjitha kërkesat mund të realizohen menjëherë, pasi planifikimi buxhetor duhet të bëhet duke marrë parasysh kapacitetet financiare të Komunës, prioritetet dhe kompetencat ligjore. Megjithatë, të gjitha kërkesat e paraqitura do të evidentohen dhe do t'u përcillen drejtorive përkatëse për shqyrtim.

Adelina Paqarizi: Kërkoj që të merret parasysh gjendja e grave të moshuara, veçanërisht e atyre që jetojnë vetëm ose që nuk kanë burime të mjaftueshme financiare. Ajo theksoi se për këtë kategori nevojitet një mbështetje më e madhe sociale dhe institucionale.

Gjithashtu, kërkoj që të shqyrtohet mundësia e **subvencionimit të lindjeve për nënat**, si një formë e mbështetjes për familjet dhe nënat e reja.

Afrim Limani: Falënderoi znj. Paqarizi për kërkesat e paraqitura dhe theksoi se çështjet sociale do të shqyrtohen në kuadër të programeve dhe mundësive buxhetore të Komunës. Ai nënvizoi se mbështetja e familjeve dhe kategorive në nevojë është një çështje që kërkon planifikim dhe koordinim ndërmjet drejtorive përkatëse.

Adelina Paqarizi: Paraqiti kërkesën për sigurimin dhe mbështetjen e shërbimeve të **fizioterapisë dhe logopedisë**, veçanërisht për fëmijët, personat me aftësi të kufizuara dhe familjet që nuk kanë mundësi financiare për t'i siguruar këto shërbime në mënyrë private.

Ajo gjithashtu kërkoj që Komuna të shqyrtojë mundësinë e përmirësimit dhe stabilizimit të **shërbimeve për shëndetin mendor**, duke theksuar se nevoja për këto shërbime është e rëndësishme për komunitetin.

Afrim Limani: Theksoi se kërkesat për shërbime shëndetësore dhe sociale do të evidentohen dhe do të trajtohen në bashkëpunim me drejtoritë kompetente. Ai theksoi se qëllimi është që shërbimet publike të jenë sa më të qasshme për qytetarët dhe veçanërisht për kategoritë që kanë nevojë të veçanta.

Adelina Paqarizi: Ngrii edhe çështjen e **qenve endacakë**, duke kërkuar që Komuna të ndërmarrë masa për trajtimin e këtij problemi dhe për rritjen e sigurisë së qytetarëve.

Po ashtu, kërkoj **përmirësimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik në lagjen Kubëza**, duke theksuar se ndriçimi publik ndikon në sigurinë dhe në përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve.

Afrim Limani: U shpreh se çështjet që lidhen me sigurinë dhe infrastrukturën publike do t'u përcillen drejtorive kompetente për shqyrtim dhe trajtim, duke marrë parasysh prioritetet dhe mundësitë e Komunës.

Adelina Paqarizi: Kërkoj që Komuna të hartojë një plan më të strukturuar për **mbështetjen e bizneseve**, duke shqyrtuar mundësitë për lehtësime dhe forma të tjera të përkrahjes për bizneset lokale.

Ajo theksoi gjithashtu nevojën për mbështetje më të madhe për **personat me aftësi të kufizuara**, duke përfshirë shërbimet e nevojshme dhe mbështetjen për nevojat e tyre bazë.

Afrim Limani: Theksoi se zhvillimi ekonomik dhe mbështetja sociale janë të ndërlidhura dhe se Komuna do të shqyrtojë mundësitë për mbështetjen e bizneseve dhe kategorive në nevojë në kuadër të programeve për vitin 2027.

Ai shtoi se çdo masë financiare duhet të planifikohet në mënyrë të qëndrueshme dhe në përputhje me kapacitetin buxhetor të Komunës.

Adelina Paqarizi: Kërkoj që të shqyrtohet mundësia e funksionimit të **çerdhes publike edhe gjatë periudhës së verës**, pasi kjo do t'u ndihmonte prindërve, veçanërisht nënave të punësuar, në organizimin e kujdesit për fëmijët.

Gjithashtu, kërkoj krijimin e mundësive të reja për **punësim dhe mbështetje për bizneset start-up**, me fokus të veçantë tek të rinjtë dhe të sapodiplomuarit. Ajo theksoi se skemat e subvencionimit për bizneset e reja mund të ndikojnë në krijimin e vendeve të reja të punës dhe në zhvillimin ekonomik lokal.

Afrim Limani: E vlerësoi kërkesën për mbështetjen e të rinjve dhe bizneseve të reja si një çështje të rëndësishme për zhvillimin ekonomik. Ai theksoi se mundësitë për subvencionimin e bizneseve të reja do të shqyrtohen në kuadër të programeve dhe kapaciteteve buxhetore për vitin 2027.

Sa i përket çerdhes publike, ai theksoi se çështja do të shqyrtohet nga strukturat përkatëse, duke marrë parasysh nevojat e prindërve dhe mundësitë për organizimin e shërbimit gjatë periudhës së verës.

Adelina Paqarizi: Në fund të diskutimit kërkoj që në kuadër të Buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027 të shqyrtohet mundësia e krijimit të një **linje të veçantë buxhetore për SHPG "Hareja"**, për mbështetjen e aktiviteteve dhe funksionimit të organizatës.

Ajo theksoi se një mbështetje e tillë do t'i mundësonte organizatës të zhvillojë më shumë aktivitete në funksion të grave, familjeve dhe komunitetit në përgjithësi.

Afrim Limani: Falënderoi znj. Paqarizi për të gjitha kërkesat dhe propozimet e paraqitura. Ai theksoi se kërkesa për linjë të veçantë buxhetore do të shqyrtohet në kuadër të procedurave dhe mundësive buxhetore të Komunës.

Drejtori Limani theksoi se qëllimi i dëgjimeve buxhetore është që kërkesat e komunitetit të merren parasysh gjatë hartimit të buxhetit dhe se Komuna do të bëjë përpjekje që kërkesat e arsyeshme dhe të realizueshme të përfshihen në planifikimet përkatëse.

III. PËRFUNDIMI I TAKIMIT

Afrim Limani: Në përfundim të dëgjimit buxhetor falënderoi znj. Adelina Paqarizi për pjesëmarrjen dhe kontributin e dhënë në procesin e planifikimit të Buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2027.

Ai theksoi se të gjitha kërkesat dhe propozimet e paraqitura gjatë takimit do të evidentohen dhe do t'u përcillen drejtorive përkatëse për shqyrtim, në përputhje me kompetencat komunale, prioritetet dhe mundësitë buxhetore.

Në veçanti, u theksua rëndësia e vazhdimit të **buxhetimit gjinor**, përfshirjes së grave dhe grupeve të tjera të synuara në proceset vendimmarrëse, si dhe krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët.

Takimi u përmbyll me pajtimin që komunikimi ndërmjet Komunës dhe SHPG "Hareja" të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të identifikimit të nevojave të komunitetit dhe adresimit të tyre përmes politikave, programeve dhe mundësive buxhetore të Komunës.

Procesverbali u hartua më datë: 24.07.2026.